




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN	
Nr. / Br.	51324/21
Nr. i fq. / Br. st.	-1-
Data: / Datum:	21/09/2021
VUSHTRRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

PROCESVERBAL

Nga takimi me qytetarë mbajtur në fshatin Reznik, lidhur me dëgjimet buxhetore për vitin 2022-2024

Mbledhja u mbajt me datën 27.08.2021 me fillim në ora 20:00, në Shkollën "Martirët".
Prezent nga zyrtarët e komunës:

1. z. Xhafer Tahiri- kryetar i komunës
2. z. Afrim Namani –nënkryetar i komunës etj.

Nga banorët e atij lokaliteti ishin të pranishëm 24 pjesëmarrës. Prej tyre 22 meshkuj dhe 2 femra.

Rend Dite

1. Dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2022-2024

Fjala hyrëse:

Kryetari i komunës zotëri Xhafer Tahiri fillimisht i njoftoj të pranishmit në pika të shkurtër lidhur me investimet e bëra gjatë këtyre viteve të udhëheqjes së tij me komunën, duke filluar me projektet infrastrukturore si shtrimin e rrugëve me asfalt, subvencionet e dhëna për fermerët, investimet në objektet edukativo-arsimore, ndërtimi i fushave sportive, rregullimin dhe mirëmbajtjen e shtatit të lumenjve, rregullimin e shesheve në qytet, prurjen e ujit të pijes në pothuajse tërë territorin e komunës, menaxhimin e mbledhjes së mbeturinave, projekti pothuajse në mbarim për ndërtimin e zonës ekonomike, etj.

Pas përfundimit të fjalës hyrëse, u hap diskutimi:

1. Ismet Makiqi, kërkon që rruga "Rilindja" të varrezat e fshatit të rregullohet, gjithashtu edhe rruga "Balltaku" kërkon të hapet për kalim.

2. Xhavit Halili, kërkon që rruga “Halili” të rregullohet.
3. Kadri Rustemi. Kërkon të ketë ndriçim në shtyllat elektrike, gjithashtu edhe ndërrimin e shtyllave të vjetërsuara.
4. Samiu, kërkon të ketë trotuar “Te Bellopojt”.
5. Gazmendi, si problem e cekë çështjen e kanalizimit në lagjen “Curri”.
6. Ismet Makiqi, kërkon të rregullohet kanalizimi në lagjen “Selimi”.
7. Sabri Bellopoja, kërkon të ketë shtylla elektrike.
8. Brikena Thaqi, kërkon kërkoj më shumë informata rreth infermierisë.

Kryesuesi i këtij takimi theksoj se këto kërkesa do të shqyrtohen në ekzekutivin e komunës, Komitetin për politikë dhe financa dhe rekomandohen për miratim në kuvendin e komunës për aprovim varësisht prej prioriteteve që do të përcaktohen si dhe varësisht prej disponueshmërisë buxhetore për investime kapitale për v. 2022-2024.

Procesmbajtës:

Premtim Maloku

